



## Dritë që vjen nga Perëndimi ...

**Bashkim Shehu**

Ose dritë që lind nga perëndon. Kështu thotë – cituar sipas kujtesës – një varg i poetit kombëtar të shqiptarëve, Naim Frashëri. Është një përmbysje e shprehjes “dritë që vjen nga Lindja”, shprehje e njohur që shenjon me ngjyrimë kremtuese ndikimin e doktrinafe fetare dhe mistike të Lindjes ndaj Europës, një fluks i vazhdueshëm dhe i përsëritur, që nga ndikimi i asiro-babilonasve ndaj grekëve e deri te budizmi *zen* i të rinjve perëndimorë në të hyrë të postmodernitetit. Më anë tjetër, kjo shprehje u përvetësua nga një pjesë e marksistëve perëndimorë mbas Revolucionit të Tetorit. Ndërsa Naim Frashëri, i cili me siguri do të ketë qenë krejt i familjarizuar me denotacionin mistik të saj, e përmbys duke aluduar për Iluminizmin. Po për ne, shqiptarët e sotëm, a ka të njëjtin kuptim sikurse për Naim Frashërin drita që vjen nga Perëndimi?

Sot, kjo pyetje lidhet gjithsesi me aspiratën shqiptare për të aderuar në Bashkimin European dhe me legjitimitetin e kësaj asperate, i cili, tekefundit, ka të bëjë me vetëperceptimin e shqiptarëve si europeanë. Por çdo vetëperceptim sfidohet nga përballja me perceptimin prej të tjerëve, madje ndikohet apo edhe kushtëzohet prej tij.

Europa dhe Shqipëria, Ballkani dhe Europa. Këto sintagma aq të shpeshta saqë duken si të vetëkuptueshme, ose ndoshta duken si të vetëkuptueshme për shkak të përsëritjes së tyre të shpeshtë, përmbajnë një ambiguitet mjaft problematik. Në një mënyrë apo në një tjetër, nënkuptojnë se Ballkani, pra edhe Shqipëria, nuk është plotësisht Europë, apo së paku lënë shteg për një nënkuptim të tillë të mundshëm. Kësodore, si *plotësisht Europë* shikohet vetëm Europa perëndimore dhe, rrjedhimisht, banorëve të gjysmës tjetër të kontinentit, nëse duan të jenë të tillë *plotësisht* dhe me qenë se gjeografinë, këtë përftesë natyrore apo që mendohet si fatalitet natyror, s’e

ndryshojnë dot, s'u mbetet veçse rruga e artificit njerëzor, domethënë rruga institucionale, ajo e aderimit në Bashkimin European. Dhe pyetja e mësipërme shndërrohet në një tjetër: a i takon Shqipërisë të jetë, në një të ardhme të prekshme, anëtare e Bashkimit European?

Përtej qasjeve historiko-romantike, që evokojnë Skënderbeun si mburojë e Europës, apo arkaikisht identitetin zanafillor të krishterë në Mesjetë, si identitet i përputhshëm me një pseudoesencë europiane, apo, edhe më arkaikisht, mitin e vjetërsisë shqiptare në këto treva që fqinjërojnë me Greqinë klasike dhe, prandaj, nëpërmjet një rrëshqitjeje të lehtë, mund të njësohen me Greqinë klasike apo edhe ta tejkalojnë fuqishëm siç tejkaloreshin gjithmonë planet pesëvjeçare në të kaluarën tonë të afërt – përtej të gjitha këtyre, pra, le të përiqemi të shohim “protë” dhe “kundrat” e mundshme në lidhje me Shqipërinë si anëtare e Bashkimit European.

Shqipëria, ndonëse tashmë ka hyrë në fazën e bisedimeve për anëtarësim, ka një rrugë ende shumë, shumë të gjatë për të bërë gjersa të plotësojë standardet e kërkuara. Këtë e dinë të gjithë. Mjafton të shohim gjendjen e asaj çka është elementare dhe njëkohësisht themelore për demokracinë: zgjedhjet. Ende mbas tridhjetë vjetësh pluralizëm, rrallëherë ka ndodhur që rezultati të pranohet nga të dyja palët. Për më tepër, duke deklaruar se nuk mund ta marrë pushtetin me anë të votave, opozita aktuale praktikisht u vë një pikëpyetje të madhe zgjedhjeve si modalitet që, në instancë të parë dhe të fundit, përcakton se kush duhet ta qeverisë vendin. Në këto kushte, nga pikëpamja e demokracisë, çështja nëse për këtë e ka fajin opozita apo, përkundrazi, shumica në pushtet, është e parëndësishme. Veç asaj, sipas autoriteteve juridike shqiptare, korrupsioni është i përhapur në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet e administratës shtetërore. Këto vite janë bërë hapa për ta reformuar sistemin e drejtësisë duke pasur si qëllim kryesor pikërisht luftën kundër korrupsionit, e megjithatë duket se ekziston një konsens publik se gjendja e funksionimit të institucioneve dhe e shtetit të së drejtës lë ende shumë për të dëshiruar.

Vërtet, Bashkimi European nuk është i detyruar *de jure* që të pranojë perspektivën e anëtarësimit të një shteti apo të një tjetri. Por Bashkimi European e ka pranuar një perspektivë të tillë për Shqipërinë qysh në vitin 2003. Kjo përbën një premtim. Kështu që, për t'u anëtarësuar, tani Shqipëria ka detyrimin që të përmbushë

standartet përkatëse. Dhe me këtë premtim takohet një tjetër element i legjitimitetit për t'u anëtarësuar, diçka që e përmendëm edhe më sipër: aspirata e qytetarëve të Shqipërisë. Është më e fortë se në çdo vend ish-komunist. Natyrisht, përmbajtja qëllimore e kësaj aspirote ndryshon nga ajo e dritës që shihte Naim Frashëri të lindte andej nga perëndon. Ka një pamje më praktike, apo më konkrete, vetëm se jo thjesht materialiste: përpos përmirësimit të gjendjes ekonomike, pritet që procesi i aderimit në Bashkimin Europian të sjellë edhe zhdukjen e korrupsionit në shtetin shqiptar, apo së paku një turrje të tij shumë të ndjeshme.

Sidoqoftë, legjitimiteti i aspiratës shqiptare për të hyrë në Bashkimin Europian përforcohet edhe nga një tjetër argument, që ka të bëjë pikërisht me themelet morale të Bashkimit Europian. Ndonëse i krijuar fillimisht si treg i përbashkët, projekti për një hapësirë të përbashkët europiane të demokracive lindi, në thelb, si një projekt kundër së kaluarës europiane të luftës dhe të tmerreve të saj, po edhe si një projekt kundër së keqes së pranishme, asaj të diktaturave staliniste në gjysmën tjetër të kontinentit. Prandaj, vendet perëndimore të kësaj hapësire të përbashkët u kanë një borxh vendeve të Lindjes, ndër të cilat edhe Shqipëria. “Risja demokratike, në ditët e sotme, konsiston në të gjitha protestat, në të gjitha revoltat që po ndodhin në Lindje, të cilat i rikthejnë kuptimin [demokracisë]”, shkruan mendimtari i shquar francez Claude Lefort më 1981. Dhe, në mënyrë gjithnjë e më të prekshme, shlyerja e këtij borxhi është konkretizuar, së paku deri tani, në formën e aderimit në Bashkimin Europian. Tekfundit, përkundër idesë që vendet e Lindjes nuk janë plotësisht Europë, me më shumë të drejtë mund të thuhet se Europa nuk është plotësisht vetja e saj pa vendet e Lindjes. Dhe, kur flitet për integrim, nuk duhet harruar se integrimi është proces i dyanshëm: nga njëra anë, vende si Shqipëria duhet të ndryshojnë duke iu afruar atyre të Perëndimit për nga standardet e demokracisë dhe të drejtësisë, ndërsa nga ana tjetër vendet e vjetra anëtare duhet të ndryshojnë mendësinë dhe perceptimin duke pranuar të jetojnë në një hapësirë të përbashkët ndërshtetërore të ndryshme nga e dikurshmja dhe të bashkëjetojnë si të barabartë, brenda një Europe të tillë, edhe me vende “kulturalisht” si Shqipëria.

*Ky shkrim është pjesë e serise së shkrimeve “Media dhe Integrimi Europian”, të Institutit Shqiptar të Medias, në kuadrin e Programit të Promovimit të Tranzicionit të Republikës Çeke.*